



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. të datës 02.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. e datës 02.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Pro & Co" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Pro & Co" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

**Pretendimi i parë ankimor:** "Kërkesa e FDT min 1. Shkollë me sallë të sportit në vlerë 2.5 mil. euro është diskriminuose dhe e kufizon konkurrencën".

**Pretendimi i dytë ankimor:** "Kriteri lidhur me liderin për plotësimin e kërkesave maksimumi që mund të kërkohet është 60% lideri i konzorciumit të plotësoj kërkesat".

**Pretendimi i tretë ankimor:** "ju mund të kërkoni të jetë i certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë por pa kufizuar në një standard të certifikimit (OHSAS 18001)".

**Pretendimi i katërt ankimor:** "kërkojmë të mundësohet certifikim ekuivalent certifikuar për auditim të energjisë për ndërtesa pa kufizuar një standard të vecantë".

**Pretendimi i pestë ankimor:** "inxhinieri i hidroteknikës është në kundërshtim me nenin 7 të LPP pasi që nuk mund të fokusohen të gjitha ato kualifikime te një inxhinier i vetëm".

**Pretendimi i gjashtë ankimor:** "kërkojmë të hiqet si kërkesë EN13067 për dy salduesit"

**Pretendimi i shtatë ankimor:** parashtruesi kërkon të ndryshohet lista e pajisjeve.

Sa i përket pretendimit të parë dhe të dytë ankimor, mjafton plotësisht që në vend të kërkesës për min. 1 shkollë me sallë të sportit në vlerë 2.5 mil. euro të zëvendësohet me termin projekte të natyrës së ngjashme ku njëra prej tyre është min. në vlerë 2.5 mil. euro. Ndërsa sa i përket përqindjes që duhet të përmbushet nga lideri i konzorciumit duhet cekur se parashtruesi kërkon që kjo përqindje nga 70 të bëhet 60 mirëpo nuk parashtron asnjë argument për një ndryshim të tillë. Pretendimet ankimore si të tilla janë vetëm pjesërisht të bazuara.

Sa i përket pretendimit të tretë, të katërt dhe të gjashtë ankimor, standardet e kërkuara të certifikimit janë përzgjedhur pasi që janë të domosdoshme për të dëshmuar kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për të përmbushur kontratën me sukses. Pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimit të pestë ankimor, parashtruesi nuk ofron asnjë propozim si duhet të formulohet kërkesa e tillë sipas këndvështrimit të tij por vetëm pretendon se kërkesa është formuluar gabimisht. Përndryshe parashtruesi nuk e konteston kërkesën si të tillë por vetëm kërkon që të ndahet në dy ose tri kërkesa të tjera. Prandaj pretendimi ankimor është vetëm pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit të shtatë ankimor, parashtruesi pretendon se këto kërkesa nuk janë të nevojshme ose janë formuluar gabimisht mirëpo nuk prezanton asnjë argument për të mbështetur pretendimet e tij. Duhet cekur se këto dëshmi dokumentare janë të domosdoshme për të dëshmuar kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për realizimin me sukses të kontratës. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar vetëm si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RPPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 08.01.2024**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.